

Vendim nr. 87 datë 26.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 26.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **DJANA KASAPI**, përfaqësuar nga avokat Aleksandër Raspopi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4701, datë 16.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes në këtë gjykatë për shqyrtimin e rekursit ndaj vendimit nr. 1760 (86-2019-2019), datë 10.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 43, 44, 107, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, 13, 41 dhe 45 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 24, 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë pjesë e Shërbimit Civil në funksionin e përgjegjëses së sektorit të arkivit dhe protokollit në Drejtorinë Ekonomike të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Drejtësisë. Ajo është liruar nga Shërbimi Civil me vendimin nr. 1802, datë 22.02.2010 “*Për lirim nga shërbimi civil*”, të sekretarit të përgjithshëm të kësaj ministrie, për shkak të ristrukturimit të institucionit në zbatim të urdhrin nr. 29, datë 05.02.2010 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë*”, i cili ka shfuqizuar urdhrin e mëparshëm të tij nr. 30, datë 25.02.2009, si dhe ka ulur numrin total të punonjësve.

2. Vendimi nr. 1802, datë 22.02.2010, është miratuar nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) me shkresën nr. 287/1 prot., datë 18.02.2010 dhe kërkuesja ka kaluar në listën e pritjes. Me shkresën nr. 417/1 prot., datë 05.03.2010 “*Kthim përgjigjeje*”, DAP-i ka sqaruar kërkuesen se Ministria e Drejtësisë, në përputhje me strukturën dhe organikën e re, duhej të bënte përshkrimet e reja të pozicioneve të punës që i përkisnin Shërbimit Civil dhe se i kishte kërkuar ministrisë dërgimin e këtyre përshkrimeve, si dhe propozimet për sistemimin e nëpunësve nga lista e pritjes.

3. Së bashku me nëpunës të tjerë të liruar nga detyra, kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, për të cilin, me vendimin e datës 20.07.2010, kjo prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak të mungesës së anës subjektive të dashjes në kryerjen e veprimeve dhe se nga procesi nuk kishin ardhur pasoja të paligjshme. Sipas këtij vendimi, veprimet e Ministrisë së Drejtësisë ishin kryer pa u bërë më parë krahasimi i përshkrimit të punës që kishte kryer nëpunësi deri në çastin e ristrukturimit, me përshkrimin e punës për vendet e mbetura, të ristrukturuara ose me vendet e reja të krijuara. Nga Ministria e Drejtësisë ishte vlerësuar se përshkrimet e pozicioneve të krijuara nga ristrukturimi nuk përputheshin me përshkrimet e mëparshme të funksioneve të ushtruara nga nëpunësit e kaluar në listën e pritjes. Sipas prokurorisë, një vlerësim i tillë i përkiste vetë Ministrisë, e cila, bazuar në krahasimin e përshkrimeve, konkludonte nëse ato ishin të njëjta ose të ndryshme.

4. Duke mos qenë dakord me lirimin nga Shërbimi Civil dhe kalimin në listën e pritjes, kërkuesja ka ankimuar aktin e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë në

Komisionin e Shërbimit Civil (*KSHC*), për të cilin, me vendimin nr. 148, datë 02.12.2010, *KSHC*-ja ka vendosur konstatimin e pamundësisë për marrjen e vendimit përfundimtar për çështjen, si rrjedhojë e mosarritjes së kuorumit të nevojshëm ligjor.

5. Në vijim, në datën 10.01.2011 kërkuesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimit nr. 1802, datë 22.02.2010 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë e të aktit të DAP-it nr. 287/1, datë 18.02.2010, që ka miratuar kalimin e saj në listën e pritjes; detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe DAP-it për sistemimin e saj në vende pune të mbetura dhe të ristrukturuara ose në ato të reja, të krijuara me përshkrim të njëjtë ose të ngjashëm me punën që ajo ka kryer; pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa të drejtë pa punë; konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të *KSHC*-së nr. 148, datë 02.12.2010.

6. Me vendimin nr. 3063, datë 02.04.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se akti i lirimit të kërkueses nga detyra nuk ka cenuar ligjin në elementet e tij formale dhe as në procedurën e nxjerrjes së tij. Shkak për këtë ka qenë ristrukturimi i institucionit dhe në momentin e lirimit të kërkueses nga detyra nuk ishte bërë krahasimi i përshkrimit të punës që ajo kishte kryer deri në çastin e ristrukturimit me përshkrimin e punës për vendet e mbetura, të ristrukturuara ose me vendet e reja të krijuara. Po sipas gjykatës, vlerësimi i gabuar i ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*) dhe i vendimit nr. 360, datë 14.07.2000 të Këshillit të Ministrave (*VKM nr. 360/2000*), nuk ka shkaktuar pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, por pavlefshmëri relative të tij. Ndonëse kërkuesja kishte garancitë ligjore për t’u sistemuar në Shërbimin Civil, në rast se vendi i saj ishte prekur nga procesi ristrukturues, referuar këtu mundësisë për të punuar në një vend të të njëjtit nivel ose më të ulët, ajo nuk kishte paraqitur asnjë të dhënë lidhur me arsimimin dhe formimin e saj profesional, trajnimet e kryera gjatë periudhës së shërbimit në detyrë, vlerësimet nga puna ose përshkrimin e detyrës së ushtruar. Nga ana tjetër, si rrjedhojë e kalimit në listën e pritjes, kërkuesja ishte paguar një vit. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me vendimin e *KSHC*-së, gjykata ka vlerësuar se përmes tij nuk ishte disponuar në thelb për çështjen dhe se disponimin i këtij organi nuk binte në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, i cili parashikonte marrjen e vendimit me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

7. Për ankimin e kërkueses, me vendimin nr. 9, datë 10.01.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, me të njëjtat argumente.

Kërkuesja ka paraqitur rekurs, duke kërkuar ndryshimin e të dyja vendimeve të gjykatave më të ulëta.

8. Me vendimin nr. 00-2015-4535 (663), datë 03.12.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit. Kolegji ka vlerësuar se Gjykata e Apelit Tiranë kishte pasqyruar të njëjtin vendim si gjykata e rrethit dhe nuk ishte shprehur për shkaqet e ngritura nga kërkuesja në ankim, për rrjedhojë i mungonin arsyet dhe përfundimet e gjykatës. Për këtë shkak, kërkueses i ishte mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

9. Me vendimin nr. 1760 (86-2019-2019), datë 10.06.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3063, datë 02.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se akti administrativ që e ka liruar kërkuesen nga detyra ishte vetëm vendimi i sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa shkresa nr. 287/1 prot., datë 18.02.2010 e DAP-it nuk përbënte akt administrativ, pasi DAP-i nuk kishte si kompetencë përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil. Po sipas gjykatës, vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm ishte nxjerrë në përputhje me parashikimet ligjore, pasi ishte marrë nga organi kompetent, në zbatim të kompetencave të tij, sipas pikës 7 të VKM-së nr. 360/2000. Ai nuk kishte cenuar ligjin në elementet e tij formale dhe as në procedurën e nxjerrjes së tij. Moskryerja e krahasimit të përshkrimit të punës që kërkuesja kishte kryer me përshkrimin e punës për vendet e mbetura, të ristrukturuara, ose me vendet e reja të krijuara, nuk përbënte shkelje flagrante të ligjit, për moszbatim të tij, pra nuk shkaktonte pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, por pavlefshmëri relative të tij, në kuptim të nenit 118 të Kodit të Procedurës Administrative (*KPA*). Po kështu, faktet e ngjara pas kalimit të kërkueses në listë pritje, si marrja e punonjësve të tjerë me kontrata pune, krijimi i vendeve të reja të punës në këtë ministri ose në ministri të tjera, nuk cenonte përmbajtjen e aktit administrativ, pasi në përcaktimin e bazueshmërisë faktike dhe juridike të tij, në kuptim të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, merrej parasysh situata që kishte ekzistuar në momentin e nxjerrjes së tij. Fakti i pretenduar nga kërkuesja, pasja e vendeve të lira në një pozicion me të ulët në Ministrinë e Drejtësisë në kohën e lirimit të saj nga Shërbimi Civil, nuk përbënte nulitet të aktit të lirimit të saj nga detyra, por në eventualitet paligjshmëri të tij, çka merrej në shqyrtim vetëm kur nëpunësi e kundërshtonte gjyqësisht aktin administrativ brenda afatit të prerë prej 30 ditësh, sipas nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për pasojë, gjykata ka vlerësuar se akti administrativ i largimit të kërkueses nga Shërbimi Civil nuk ishte absolutisht i pavlefshëm,

ndaj padia për konstatimin si të tillë të vendimit nr. 1802, datë 22.02.2010 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, duhej rrëzuar, si e pambështetur në ligj.

10. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kërkuesja ka ushtruar rekurs, duke pretenduar, ndër të tjera, se vendimi për lirim nga detyra dhe kalimin në listën e pritjes ishte absolutisht i pavlefshëm, pasi procesi i ristrukturimit nuk ishte menaxhuar në përputhje me ligjin e Shërbimit Civil dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; procesi duhej të fillonte përmes një studimi të veçantë, që përlligjte nevojën e institucionit për ristrukturim; në momentin e daljes së vendimit të ristrukturimit nuk ishin bërë përshkrimet e punës së vendeve të reja; akti i lirit nuk kishte mbajtur parasysh vlerësimet pozitive të punës së saj dy vitet e fundit; ligji ishte interpretuar e zbatuar keq dhe në kundërshtim me vendimet nr. 246, datë 25.03.2014; nr. 399 datë 25.06.2014 e nr. 420, datë 08.07.2014 të Kolegjeve Administrative të Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; akti ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material; gjykatat kishin bërë vlerësime të ndryshme, pasi gjykata e rrethit i ishte përmbajtur vetëm rasteve të pavlefshmërisë absolute, ndërsa gjykata e apelit kishte arsyetuar se mungesa e procedurës në lidhje me krahasimin e përshkrimit të punës nuk përbënte shkelje flagrante të ligjit; arsyetimi i gjykatës në lidhje me pasojën për pagimin e pagës ishte i pabazuar, pasi ligji nuk parashikonte periudhën e pagesës, por ruajtjen e nivelit të pagës për një vit e, më pas, mundësinë e ofrimit të një vendi pune të një niveli më të ulët.

11. Në datën 19.04.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj. Bazuar në nenin 482, pika 4, të KPC-së, relatori ka përshpejtuar gjykimin, duke vlerësuar se, bazuar në natyrën e saj, si dhe faktin se çështja kishte ardhur për herë të dytë në Gjykatën e Lartë, kishte shkaqe për përshpejtim. Në përfundim të shqyrtimit të rekursit, me vendimin nr. 00-2023-4701, datë 16.11.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2021 ose problematika të tilla që përbënin zbatim të gabuar të ligjit material e procedural ose që ato të ishin të tilla që paraqisnin rëndësi themelore për zhvillimin, sigurinë ose njësimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, nuk pretendohet se vendimi binte ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe kërkuesja nuk kishte parashtruar asnjë shkelje të rëndë të normave procedurale.

12. Në datën 19.02.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.02.2024.

II

Pretendimet e kërkuësës

13. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

- 13.1. *Garancia e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë*, e parashikuar nga neni 107 i Kushtetutës. Ligji nr. 8549/1999 dhe VKM-ja nr. 360/2000 garantonin punën e nëpunësit publik dhe, në rastet e ristrukturimit të institucionit, ofrimin nëpunësit publik, vendi i të cilit ishte deklaruar i tepërt, të një vendi të të njëjtit nivel në një ministri ose institucion tjetër të administratës qendrore ose vendore dhe, në pamundësi, të një vendi të një niveli më të ulët. Sipas VKM-së, nëpunësi që kishte kryer punë me përshkrim të njëjtë ose të ngjashëm me përshkrimin e vendeve të reja, të krijuara ose të mbetura dhe ristrukturuara, dhe që ishte vlerësuar pozitivisht 2 vjetët e fundit, mbahej në punë në kufirin e përgjithshëm të vendeve të miratuara. Në rastin e saj nuk kishte asnjë arsye që ajo të largohej nga Shërbimi Civil. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nuk ka vepruar në përputhje me parimin e përgjegjshmërisë. Shkelja prej tij e procedurës në nxjerrjen e aktit e bën atë absolutisht të pavlefshëm. Motivi i largimit të saj nga detyra ka qenë ai politik.
- 13.2. *E drejta për t'u rehabilituar në përputhje me ligjin*, e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si rrjedhojë e veprimeve të paligjshme të organit shtetëror. Gjykatat kanë pranuar se akti është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që nuk kanë pranuar të zgjidhin pasojat e shkaktuara prej tij.
- 13.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:
- 13.3.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat kanë pranuar pavlefshmërinë relative të aktit të lirimit nga detyra, ndërkohë që nuk kanë zgjidhur pasojat e ardhura prej tij.
- 13.3.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për qëndrimet e palëve në lidhje me mosmarrëveshjen, zgjidhjen e pasojave të aktit të pranuar si të pavlefshëm nga gjykatat më të ulëta, ose llojin e pavlefshmërisë së aktit. Arsyetimi i saj përmbledhet vetëm në një

pikë dhe nuk është i mjaftueshëm, pasi nuk parashtron qëndrimin e kësaj gjykate për thelbin e mosmarrëveshjes. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuësja nuk ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjeve Administrative ose me vendime të Kolegjeve të Bashkuara të saj, ndërkohë që në rekurs janë parashtruar vendimmarrje të këtyre kolegjeve, si argumente kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, Gjykata e Lartë është shprehur se rekursi është paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe se kërkuësja nuk ka paraqitur kundërrekurs, ndërkohë që rekursi është ushtruar prej saj.

13.3.3. Gjykatat e faktit nuk kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin material dhe procedural në përputhje me praktikën gjyqësore të kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate. Po kështu, në kundërshtim me nenin 141 të Kushtetutës, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk siguron njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

13.4. *E drejta e pronës private*, pasi në kushtet kur lirimi i saj nga detyra është bërë në kundërshtim me ligjin, duhej t'i jepej paga e plotë nga dita kur i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

15. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, në thelb, kërkuesja ka kundërshtuar edhe gjykimin e zhvilluar në gjykatat më të ulëta. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara, Kolegji vlerëson se shkakut politik i largimit nga detyra nuk është ngritur në gjykatat e zakonshme, duke mos u trajtuar në thelb nga këto gjykata, për rrjedhojë në lidhje me të kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji çmon se kërkuesja ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, ndaj nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Një ndër kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual është edhe ai i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit.

19. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 16.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e garancisë së qëndrimit në detyrë dhe trajtimit ligjor të nëpunësve publikë, së drejtës për t’u rehabilituar në përputhje me ligjin, së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën për pronë private, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

21. Për sa u përket pretendimeve të kërkuases për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e ulëta në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe mospagimin nga kjo e fundit të njësisimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson se ato nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

22. Nga ana tjetër, në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar cenimin e nenit 107 të Kushtetutës, së drejtës për t'u rehabilituar, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe së drejtës së pronës private. Duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve, si dhe faktin se pretendimet në lidhje me të drejtën e pronës private ngrihen në kuadër të procesit gjyqësor të nisur prej saj për pavlefshmërinë absolute të aktit të lirit nga detyra, Kolegji çmon t'i analizojë ato në vijim, në drejtim të së drejtës së aksesit në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit

23. Kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit, pasi gjykatat kanë pranuar se akti i lirit nga detyra është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që nuk kanë zgjidhur pasojat e shkaktuara prej tij. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk është shprehur për qëndrimet e palëve në lidhje me mosmarrëveshjen, zgjidhjen e pasojave të aktit të pranuar si të pavlefshëm nga gjykatat më të ulëta, ose llojin e pavlefshmërisë së aktit. Arsyetimi i saj përmbledhet vetëm në një pikë dhe nuk është i mjaftueshëm, pasi nuk parashtron qëndrimin e kësaj gjykate për thelbin e mosmarrëveshjes. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuësja nuk ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjeve Administrative ose vendime të Kolegjeve të Bashkuara të saj, ndërkohë që në rekurs janë parashtruar vendimmarrje të këtyre kolegjeve, si argumente kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, Gjykata e Lartë është shprehur se rekursi është paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe se kërkuësja nuk ka paraqitur kundërrkurs, ndërkohë që rekursi është ushtruar prej saj. Po sipas kërkuases, largimi i saj nga detyra është bërë në kundërshtim me nenin 107 të Kushtetutës dhe gjykatat i kanë cenuar të drejtën për t'u rehabilituar, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin

vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesimi në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtarë (*shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023; nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 7, datë 21.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, Kolegji konstaton se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit, pas kthimit të saj për rishqyrtim në këtë gjykatë nga Gjykata e Lartë, është bërë në prani të përfaqësuesit të kërkueses dhe asaj i është dhënë mundësia të parashtrijë argumentet për çështjen, si dhe të paraqesë prova në mbrojtje të

interesave vetjakë. Në lidhje me pretendimet e saj për çështjen, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se akti i lirimit nga detyra nuk ka cenuar ligjin në elementet e tij formale dhe as në procedurën e nxjerrjes së tij, si dhe vlerësimi i gabuar i ligjit nr. 8549/1999 gjatë procedurës administrative nuk e bënte aktin absolutisht të pavlefshëm, por relativisht të pavlefshëm. Sipas gjykatës, neni 116 i KPA-së ka parashikuar një listë shteruese të rasteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ dhe kjo pavlefshmëri nënkupton shkelje flagrante dhe të rëndë të ligjit dhe përbën situatë të parikuperushme, sipas nenit 117 të KPA-së. Aktet e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe DAP-it nuk kanë cenuar ligjin në nivel pavlefshmërie absolute dhe shkak për lirimin e kërkueses nga detyra ka qenë ristrukturimi i institucionit. Nga ana tjetër, ajo është paguar një vit, si rrjedhojë e kalimit në listën e pritjes. Ndonëse garancitë që ofron ligji nr. 8577/1999 nuk i janë ofruar, kërkuësja nuk ka provuar përshtatshmërinë e saj me vendet e pretenduara për në Ministrinë e Drejtësisë (*shih faqet 10-12 të vendimit nr. 3063, datë 02.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

28. Në rigjykimin e çështjes, si rrjedhojë e kthimit të saj për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosarsyetimit të shkaqeve të mospranimit të ankimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se vendimi i sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk kishte cenuar ligjin në elementet e tij formale dhe as në procedurën e nxjerrjes së tij, pasi ishte marrë nga organi kompetent, në zbatim të kompetencave të tij, sipas pikës 7 të VKM-së nr. 360/2000. Moskryerja e krahasimit të përshkrimit të punës që kërkuësja kishte kryer me përshkrimin e punës për vendet e mbetura, të ristrukturuara, ose me vendet e reja, të krijuara, nuk përbënte shkelje flagrante të ligjit, pra nuk shkaktonte pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, por pavlefshmëri relative të tij, në kuptim të nenit 118 të KPA-së. Faktet e ngjara pas kalimit të saj në listën e pritjes, si marrja e punonjësve të tjerë me kontrata pune, krijimi i vendeve të reja të punës në këtë ministri ose në ministri të tjera, nuk cenonin përmbajtjen e aktit administrativ, pasi në përcaktimin e bazueshmërisë faktike dhe juridike të tij, në kuptim të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, merrej parasysh situata që kishte ekzistuar në momentin e nxjerrjes së tij. Fakti i pretenduar nga kërkuësja, pasja e vendeve të lira në një pozicion me të ulët në Ministrinë e Drejtësisë, në kohën e lirimit të saj nga Shërbimi Civil, nuk përbënte nulitet të aktit të lirimit të saj nga detyra, por paligjshmëri të tij, çka merrej në shqyrtim vetëm kur nëpunësi e kundërshtonte gjyqësisht aktin administrativ brenda afatit të prerë 30-ditor, sipas nenit 328 të KPC-së. Për pasojë, akti administrativ i largimit të kërkueses nga Shërbimi Civil nuk ishte absolutisht i pavlefshëm, ndaj padia për konstatimin si të tillë të vendimit nr. 1802, datë 22.02.2010 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë

duhej rrëzuar, si e pambështetur në ligj (*shih faqet 17-20 të vendimit nr. 1760 (68-2019-2019), datë 10.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

29. Për rekursin e kërkueses, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në të nuk ngriheshin problematika të tilla që përbënin zbatim të gabuar të ligjit material e procedural ose që ato të ishin të tilla që paraqisnin rëndësi themelore për zhvillimin, sigurinë ose njësimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, nuk pretendohet se vendimi binte ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe kërkuësja nuk kishte parashtruar asnjë shkelje të rëndë të normave procedurale (*shih faqen 10, paragrafi 21, të vendimit nr. 00-2023-4701, datë 16.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

30. Në këndvështrim të këtyre vendimmarrjeve përkundrejt pretendimeve të kërkueses, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendohet, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë marrë në analizë argumentet e parashtruara nga ajo, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet në të cilat kanë mbështetur qëndrimin e tyre për pavlefshmërinë relative të aktit të kundërshtuar të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Qëndrimet e këtyre gjykatave i janë nënshtruar në vijim vlerësimit të ligjshmërisë nga Gjykata e Lartë, e cila i ka konsideruar të pabazuara shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuësja. Po kështu, pavarësisht se në rekurs kërkuësja ka parashtruar vendimmarrje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si argumente për paligjshmërinë e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar qëndrimin e saj për mospranimin e tyre, duke çmuar se nuk ishin të tilla që binin ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

31. Nga ana tjetër, ndonëse në vendim Gjykata e Lartë është shprehur se rekursi është paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe kërkuësja nuk ka paraqitur kundërrekurs, Kolegji çmon se mospasqyrimi i saktë i këtij fakti nga Gjykata e Lartë nuk është i tillë që e bën procesin, në tërësinë e tij, të parregullt në këndvështrimin kushtetues dhe nuk rezulton në cenim të së drejtës së kërkueses për akses në këtë gjykatë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

32. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.